

Mirësevini në faqen web të Queer Pride Parade dhe Festival në Tábor 2009.

Edhe pse nuk mund të sigurojmë të gjithë përmbajtjen në Shqip, kemi përkthyer faqen hyrëse për të shpjeguar disa nga gjërat kryesore.

E thënë thjesht, ne duam të festojmë dhe nuk mund të kishte patur një kohë më të mirë. Pas mbajtjes të Queer Pride Parade Cek në Brno në Qershor të 2008, nevoja për të krijuar këtë traditë është e domosdoshme. Të drejtat e Queer janë të drejta njerëzore, do të thotë të qenësishme dhe jo të akorduara. Ky festim nuk është protest. është një mundësi për të ngritur vetëdijen, dukshmërinë dhe pranimin e komunitetit Queer dhe problemeve që lidhen me këtë komunitet në Republikën Çeke. Sidoqoftë, është një festim për këdo, pa dallim gjinie, identiteti apo preference seksuale. Të gjithë kemi nevojë të vërehemi dhe të bëjmë që zërat tanë të dëgjohen.

Ne gjithëashtu duam të ndajm festimin tonë me mbështetës anë e mbanë botës. është me rëndësi të mësoh nga bashkësi të forta po aq sa edhe t'ju ofrosh forcë dhe mbështetje bashkësive në zhvillim. Ne ju ftojmë të gjithëve të bashkoheni me ne për ta bërë këtë festim një shembull të vërtet të bashkimit dhe ritjes sonë, pa përmendur këtu të gjithë argëtimin!

Në këtë faqe ju do të mësoni se si mund të regjistroh veten, grupin tënd, qëllimin apo stendën; të ofrosh një performancë, ekspozitë, ëorkshop apo trajnim; sit të jesh vullnetar, të ngresh fonde, të reklamosh; dhe patjetër, mund të gjesh informata praktike mbi programin e paradës dhe festivalit, qëndrim, ushqim, projekte dhe biznese miqsore ndaj Queer në Tábor, kujdesje për fëmijët, parkim dhe parashikimet e motit. Prandaj, nxirrni kalendarët, palmet dhe iPhoneat dhe shkruani: E Shtunë 20 Qershor 2009.

Shiemi këtu

CESTA dhe Komiteti Organizues I Queer Pride Parade and Festival në Tábor